

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegj i përbërë nga gjyqtarët Abdullah Ahmeti, kryetar, Dr.sc.Driton Muharremi, Mejreme Memaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit XH.H. nga Ferizaj, për shkak të veprës penale, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 i KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore ne Ferizaj e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, PKR.nr.117/2018 datë 26.07.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 29.01.2019 mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore ne Ferizaj, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, PKR.nr. PKR.nr.117/2018 datë 26.07.2018 **vërtetohet.**

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj-departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin PKR.nr.117/2018 datë 26.07.2018, të akuzuarin XH.H. e ka shpallur fajtorë për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 i KPRK-së, për çka e ka gjykuar me dënim burgu ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim prej dt. 27.06.2018 gjer më 26.07.2018 dhe dënimi me gjobë në shumë prej 300 (treqindte) euro, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se dënimi me gjobë nuk mund te ekzekutohet ne forma tjera te parapara me nenin 46 par.3 të KPRK-së, dënimi i caktuar me gjobë do ti shndërrohet në dënim burgu, ashtu që për çdo 20 euro do ti llogaritet një ditë burgu. Konform nenit 273 par.5 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme lënda narkotike e llojit marihuanë, me peshë rreth 3.12 gram. Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 euro, si dhe të paguaj shumën prej 50 euro ne fondin për kompensimin e viktimave të dhunës, të gjitha këto ne afat prej 15 ditëve nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur:

-Prokurori i Prokurorisë Themelore ne Ferizaj, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata Apelit aktgjykimin e kundërshtuar ta ndryshoj sa i përket sanksionit penal dhe te akuzuarit ti shqiptoj një dënim me burg më të lartë, me te cilin do te arrihej qëllimi ndëshkimorë.

Gjykata e Apelit e caktoj dhe mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, në të cilën nuk prezantuan asnjëra nga palët, edhe pse te ftuar me rregull për kohën e mbajtjes së seancës.

- Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.574/2018 të dt. 26.12.2018 ka propozuar që ankesa e Prokurori i Prokurorisë Themelore ne Ferizaj të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i lartë me burgim dhe dënim me gjobë.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa është e pa bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt, konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. As gjendja faktike nuk qe objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase nuk është kontestuar me ankesë, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në frymë të pretendimeve ankimore.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore të Prokurorit të Prokurorisë Themelore lidhur me vendimin për dënim kjo gjykatë konsideron se ankesa është e pa bazuar. Në ankesën e Prokurorisë nuk ceket ndonjë rrethanë e re e që do të ndikonte në dënimin e shqiptuar apo të cilën nuk e ka pasur të njohur gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të rrethanave që ndikojnë në lartësinë e dënimit. Prokuroria në ankesë thekson se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit të akuzuarit i ka shqiptuar dënim të butë krahasuar me peshën e veprës penale të kryer, përgjegjësinë e te akuzuarit si dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale me qerastë Gjykata bëri zbutjen e dënimit nën kufijtë e dënimit të paraparë ligjor. Gjykata ka pas parasysh vetëm rrethanat lehtësuese se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, ka treguar sinqeritet, sjelljen e te pandehurit pas kryerjes së veprës penale, premtimin e tij se ne të ardhmen nuk do të kryej vepra penale. Mirëpo duke marr parasysh se ne rastin konkret është vërtetuar se i njëjti e ka kryer veprës penale, i njëjti është recidivist dhe ndaj të njëjtit ka aktgjykime dënuese për vepra të njëjtë penale, P.nr.2439/17, P.nr.1177/16, po ashtu edhe aktakuza te ngritura të cilat janë ne fazën e gjykimeve PP.II.1474-1/17, PP.II.1147-1/18 dhe PP.II.279-6/18, andaj ne këtë rast

dënimi i shqiptuar me burgim dhe me gjobe është jo adekuat me peshën dhe rrezikshmërinë e veprës penale, duke marrë parasysh faktin se i akuzuari ka pasur për qëllim që substancën narkotike ta shes dhe ta shpërndaj tek persona të ndryshëm.

Mirëpo, Gjykata e Apelit duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat drejtë i ka vlerësuar Gjykata e shkallës së parë dhe atë si rrethanë veçanërisht lehtësuese për të pandehurin mori pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethanë lehtësuese mori faktin se i pandehuri është penduar thellë dhe është zotuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla penale, ë këto rrethana duke i ndërlidhur me rrethanat tjera personale si moshën relativisht të re, gjendjen e rëndë ekonomike, sjelljen korrekte gjatë procedurës penale, vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor, gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënimin nën minimumin e paraparë ligjor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
PAKR.nr.605/18, më 29.01.2019

Procesmbajtëse,  
Syzana Goxhuli

Kryetar i kolegjit- gjyqtari  
1. Abdullah Ahmeti \_\_\_\_\_

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharremi \_\_\_\_\_

3. Mejreme Memaj \_\_\_\_\_